RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0021/22
Data 07.02.2022
PRISHTINË

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**BORDI I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS,** në bazë të nenit 29, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-046, për Radiotelevizionin e Kosovës, dhe në bazë të nenit 17 paragrafi 7, të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës, Bordi i RTK-së merr:

## Vendim

1. Për shkarkimin e Ernest Lumes nga pozita e Drejtorit të Radio Kosovës

## Arsyetim

U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, duke u bazuar në nenin 33 paragrafi 1.2, nenin 31 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 dhe nëparagrafi 2.3, si dhe nenin18, paragrafi 8 të Ligjit 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës (G.Z. nr. 7, 27 prill 2012), nenin 8 paragrafi 2, nenin 19 paragrafi 9, nenin 20 paragrafi 12 dhe 14, nenin 22 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës (nr. 0001/22 të datës 16.01.2022), nenin 7 paragrafi 1.1, 1.4 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore të RTK-së (nr.0736/18 të datës 05.06.2018) ka propozuar shkarkimin e Ernest Lumës nga pozita e Drejtorit të Radios.

Ligji, statuti dhe rregulloret e brendshme të RTK-së, e përcaktojnë të drejtën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së që të ndërmerr masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme. Kjo është e përcaktuar në nenin 33, paragrafi 1,7 të Ligjit 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

Bazuar në statutin e RTK-së, ud i Drejtorit të Përgjithshëm ka të gjitha përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, e që rrjedhimisht ushtron të drejtën që të korrigjojë veprimet e anëtarëve të Menaxhmentit të Lartë, të cilët i propozon për emërim dhe shkarkim.

Drejtori i Radio Kosovës, z Ernest Luma, ashtu siç është cekur edhe në vendimin për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, me datë 19 janar 2022, në kohën sa ka qenë Drejtor i Radio Kosovës ka marr pjesë në një debat politik, në një medie rivale të RTK-së, ku ka shprehur hapur qëndrime politike.

https://gazetametro.net/luma-lista-vjosa-do-te-ishte-nje-ldd-e-diteve-te-sotme-po-te-mos-bashkohej-me-vvne/

Duke vepruar në këtë mënyrë, z. Luma ka shkelur kontratën e punës, ligjin për RTK-në dhe rregulloret e brendshme.

Neni 18, paragrafi 8 i Ligjit për RTK-në përkufizon se:

> "8. Politika redaktuese e RTK-së duhet të jetë e pavarur, korrekte, profesionale, objektive, e balancuar dhe asnjanëse".

Ndërkaq Rregullorja e brendshme për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore, tek neni 7 që përcakton shkeljet e rënda, në paragrafin 1.4 konstaton se shkelje e rëndë është paraqitja në çfarëdo forme e të punësuarit të RTK-së në media të tjera vendore.

Mbi këtë bazë, z. Luma, ka bërë shkelje të rëndë të rregulloreve të RTK-së, të cilat në fakt është i thirrur t'i mbroj.

Çdo i punësuar në RTK duhet ta ketë të qartë natyrën e funksionimit të transmetuesit publik, duke u kujdesur që të mos mbajë qëndrime politike, pasi kjo mund të dëmtojë imazhin e RTK-së si transmetues i pavarur publik.

Z. Luma, edhe në kohën sa ka mbajtur pozitën redaktorit, ud Kryeredaktorit në Radio Kosovë, ka marr pjesë vazhdimisht në debate politike dhe ka bërë deklarime politike në rrjetet sociale. Disa nga sjelljet recidiviste janë të evidentuara si në vijim:

https://video.gjirafa.com/pressing-arianit-koci-milaim-zeka-ernest-luma-berat-buzhala-30-09-2020

https://kosova.info/redaktori-i-rtk-dhe-analisti-ernest-luma-ia-mbane-zhagun-ish-shefit-te-tij-te-dikurshem-thote-se-haradinaj-eshte-kandidati-i-duhur-per-president/

https://aab-edu.net/media/gazetaknn/tag/ernest-luma/

https://www.youtube.com/watch?v=en0yM21KkdE

Duke marr parasysh këto fakte të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm, bordi i RTK-së morri vendim për shkarkim të z. Luma nga pozita e Drejtorit të Radio Kosovës, pasi konsideron se i

njëjti nuk plotëson kriterin themelor për të qenë pjesë e Menaxhmentit të RTK-së, sepse nuk është i paanshëm dhe i përkushtuar për zbatimin e ligjit për RTK-në si dhe rregulloreve të brendshme.

Z. Luma do të risistemohet në një pozitë sipas përgatitjes arsimore dhe profesionale në RTK.

**Kryetar i Bordit të RTK-së**

**Besnik Boletini**




**Vendimi iu dërgohet:**

- Z. Ernest Luma;
- Anëtarëve të Bordit të RTK-së;
- Menaxhmentit të lartë të RTK-së;
- Sekretarisë së Bordit;
- Arkivit.

Prishtinë, 7 shkurt 2022

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.